



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 644/3 prot.

Pukë, më 18 .04 .2025

PROCESVERBAL I Mbledhjes së Këshillit BashkiaK Pukë

Date 18. 04 .2025

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 53, pika 3. shkronja "a" si dhe të nenit 56 të VKB nr. 14 datë 30.06.2020 "Rregullore e funksionimit të Këshillit të Bashkisë Pukë" dhe në zbatim të vendimit të kryesise së keshillit nr. 2 date 11. 04 .2025, mbledhja e radhes e keshillit te Bashkise Puke u zhvillua më datën **18 . 04 .2025** ,ora **13⁻⁰⁰** tek salla e Këshillit të Bashkisë Pukë, me këtë rend - dite:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dates 25.02.2025
2. Projekt-vendim për miratimin e dhënies së ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Shkurt** 2025.
3. Projekt-vendim " Për miratimin e Raportit të monitorimit të zbatimit të Buxhetit të vitit 2024 të Bashkisë Pukë"
4. Projekt-vendim " Për miratimin e tavaneve të shpenzimeve të programit buxhetor Afatmesëm 2026-2028 për Bashkinë Pukë"
5. Projekt –vendim : " Për miratimin e shitjes me ankand të aksioneve të klubit të futbollit " FK Terbuni" SHA me Nipt L19704301F në masën 100%"
6. Të tjera.

Ne mbledhje moren pjese: Kryetari i Bashkise z. Rrok Dodaj, Drejtore e Finances zj. Fiqirete Latifi, Pergjese e sektorit social zj. Lavdie Terbuni, Pergj. Zyres juridike z. Endrit Kraja.

Mbledhja filloi ne oren 13:20 pak me vone se ishte njoftuar. Jane prezent ne mbledhje 9 keshilltarë , pra eshte koorumi i domosdoshem per fillimin e mbledhjes.

Mbledhjen e hapi kryetari i keshillit te Bashkise z. Gjon Gjoka., i cili hodhi ne votim rendin e dites , qe u miratua me 9 vota pro.

1.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dates 25.02.2025 : Ne vijim u hodh ne votim procesverbali i mbledhjes se keshillit te dates 25.02 .2025 dhe u miratua me 9 vota pro, 0 vota kunder dhe 0 vota abstenim.

2 Projekt-vendim për miratimin e dhënies së ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Shkurt 2025**.

Me pas u diskutua dhe u hodh ne votim projekt - vendimi për miratimin e ndihmes ekonomike , duke përdorur deri ne 6% te buxhetit. **U miratua ndihma per muajin Shkurt 2025 me 9 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.**

3 . Projekt-vendim " Për miratimin e Raportit të monitorimit të zbatimit të Buxhetit të vitit 2024 të Bashkisë Pukë"

Sqaron zj. Fiqirete Latifi : Eshte projektvendim qe eshte bere ne baze te udhezimit dhe eshte lene pike nga auditi. Buxheti i shpenzuar eshte paraqitur sipas fishave , qe jane bashkengjitur projektvendimit. Me tej u sqaruan detajet sipas tabelave.

Pyetje : Enver Sulejmani: Kush e ka kerkuar : Fiqirete Latifi : Eshte lene pike nga auditi.

Tabelat a jane Vjetore? Po jane vjetore per te gjitha shpenzimet.

Ne kemi votuar kunder rritjes se çmimit te ujit, pasi uji ne Puke eshte me rrjedhje te lire dhe nuk ka shpenzime. Pse eshte rritur nga ndermarja me qender ne Shkoder?

Rrok Dodaj : Aksionet i ka me shumice Bashkia Shkoder dhe Vendimi per rritjen e çmimit nuk ka marre ne konsiderate vendimin e keshillit bashkiak Puke.

U hodh ne votim dhe **u miratua me 9 vota pro, 0 vota kunder , 0 vota abstenim.**

4. Projekt-vendim " Për miratimin e tavanëve të shpenzimeve të programit buxhetor Afatmesëm 2026-2028 për Bashkinë Pukë"

Sqaron zj. Fiqirete Latifi : Jane tavanet buxhetore standarte.

Pyetje: Enver Sulejmani: Sa eshte perqindja e rritjes nga viti ne Vit?

Pergjigje: F. Latifi: 9.7 % rritje.

U hodh ne votim dhe **u miratua me 9 vota pro, 0 vota kunder , 0 vota abstenim.**

5. Projekt –vendim : " Për miratimin e shitjes me ankand të aksioneve të klubit të futbollit " FK Terbuni" SHA me Nipt L19704301F në masën 100%"

Pyetje: Enver Sulejmani : Kush eshte i interesuar per ta blere?

Endrit Kraja : Nuk ka interes paraprak , sepse procedura do te behet me ankand te hapur.

Eshte percaktuar vlera e aksioneve nga eksperti i licensuar ne vleren 5.2 milion leke, pa asetet, sepse asetet ngelen prone e Bashkise.

Rrok Dodaj: E kena diskutuar edhe nje here ne keshille dhe keni qene te dakortesuar, po keshtu kemi bere dhe degjese publike. Eshte percaktuar vlera e aksioneve nga eksperti . Shitja eshte me ankand te hapur , shpresojme ta blejne dikush, ai qe jep çmimin me te larte mbi vleren minimale qe ka percaktuar

eksperti. Ju beje thirrje atyre qe jane te iinteresuar per ta blere, se mbeshtetja e Bashkise nuk do tju mungoje.

Enver Sulejmani: Jam dakord qe asetet te mbeten prone e Bashkise, ndersa aksionet e klubit te kalojne ne ankand dhe vlerat monetare te perdorura deri tani per klublin te vihen ne dispozicion te komunitetit ne vijim.

U hodh ne votim dhe **u miratua me 9 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.**

6. Te tjera:

1. Kerkese e Gjergj Koles : per deme ne bageti dhe djegie banese;

Behar Ademi sqaron se sipas ligjit per deme ne bageti nuk perfiton demshperblim.

Ndersa per djegien e baneses, nga grupet e konstatimit ne terren nuk rezulton se banesa e tij eshte djegur, por ka qene nje banese e braktisur prej vitesh.

Enver Sulejmani: Ne çdo kohe eshte e mundur , qe te ndihmohet nje familje ne nevoje.

Behar Ademi , sipas ligjit nuk mund te ndihmohen.

2. Kerkese e kryetarit te fshatit Kaftall: Ne fshatin Kaftall eshte Ura, ambulance dhe rruget e demtuara.

Rrok Dodaj: Punimet do t'i bejme pas zgjedhjeve, sepse kemi perfituar baze material nga aplikimet qe kemi bere. Fadroma eshte blere dhe do te jete ne sherbim te komunitetit.

Gjon Gjoka : Ambulanca te riparohet sa me pare.


3. Kerkese per titull pronesie mbi token , te trasheguar me tapi por te shpronesuar ne vitin 1987, ne lagjen Pezhve , po keshtu dhe dhenien e titullit te pronesise per banesat e ndertuara nga shteti ne vitin 1989 , dhene familjeve nga Pezhvja ne kompensim te banesave te rrafshuara nga fillimi I punimeve per ndertimin e rezurvarit vadites ne Pezhve. Kerkojne nga Bashkia te pershpejtohet procesi i legalizimit te banesave dhe dhenie e tapise per tokat , te cilat jane te lira , sepse rezervuari nuk eshte ndertuar.

Enver Sulejmani: Keshilli me pare ka miratuar 1700 dosje dhe nuk e dime fatin e tyre , se ku kane mbete.. Rrok Dodaj : Kemi kerkuar te vendoset nga Qeveria per Taksforcen ne Bashkine Puke, per dhenien e Tokes ne Pronesi, por deri tani nuk kemi pergjigje. Ne kemi interes qe secili te kete tapi per Token e tij.

4. Kerkese e Beslim Toskes per konflikt me Zyber Pemen.

Rrok Dodaj : Eshte problem I mbartur , çeshtja eshte ne gjykate.

5. Kerkese e z. Bujar Hoxha per njohje te prones se trasheguar. Nuk eshte Kompetence e Bashkise.

Besmina Alij 


ALFONS GJERGSAJ




Edmond Luka



Zanor Sabuni




Aleksander Trosh




Meson Kingi




Lore Kolaj



ALFON GJOKA



Nolue Kolaj



sekretari : bashkiat

Hazri Tahiri

